

REPublika e Kosovës/REPublika Kosova/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

MINISTRIA E FINANCAVE-MINISTARSTVO ZA FINANSIJE-MINISTRY OF FINANCE

Njësia Org. 02/MAPL Nr. Prot. 885-1/2026
Org. Jedinice: Org. Unit: Prot. No.

Nr. i faqeve 4 Data 08.05.2026
Broj strana: No. pages: Date

PRISHTINE/ PRIŠTINA / PRISHTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Financave - Ministarstvo Finansija- Ministry of Finance

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Drenasit
	Burim Bujupi , Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Hysni Mehani , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave
	Arton Ahmeti , Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave
Nga:	Bora Duli , Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave <i>Bora Duli</i>
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Medina Millaku , Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave <i>Medina Millaku</i>
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj , Udhëheqëse e Divizionit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave <i>K. Zekaj</i>
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendim



Referencë:
72/2026

I nderuar Kryetar z.Lladrovci,
I nderuari Kryesues z.Bujupi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

Vendimin 02Nr.400/01-15718 për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake nga tejkalimi në vitin 2025 të barten në vitin 2026 dhe bartjen e fondeve, bilancet e pashpenzuara te hyrave vetanake nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026.

I miratuar më datë 30.04.2026

I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 04.05.2026

I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, më datë 05.05.2026

Ministria e Financave (këtëj e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të vendimit që është subjekt i shqyrtimit, synon rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake nga tejkalimi në vitin 2025 të barten në vitin 2026 dhe bartjen e fondeve, bilancet e pashpenzuara te hyrave vetanake nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026.
2. Në shqyrtimin e mundësisë së Komunës për realizimin e aktit administrativ komunal, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtëj e tutje referuar si "LMFPP"). Po ashtu, është konsultuar Ligji Nr. 10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.
3. Kështu, në kuptim të ndarjeve buxhetore komunale, neni 8, paragrafit 6 dhe 7 i Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2026, përcakton se në rast se shuma e të hyrave vetanake të Komunës gjatë vitit i kalojnë shumat e të hyrave të ndara të asaj komune ato mjete barten në vitin 2026, si në vijim:

Neni 8

Ndarja dhe ri-ndarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak

6. Bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2026 sipas vendimit të Kuvenredit Komunal dhe autorizimeve të LMFPP-së.

7. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2025 dhe të regjistruara në SIMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për vitin 2025, barten në vitin 2026 në përputhje me vendimin e Kuvendit Komunal. Prioritet duhet të ketë ndarja e mjeteve për mbulimin e detyrimeve ekzistuese kontraktuale apo detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

4. Po ashtu, sipas nenit 27 të Ligjit 03-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ndarjet buxhetore që ndërlidhen me të hyrat vetanake të pashpenzuara të komunës do të vazhdojnë për komunën përkatëse në vitin e ardhshëm fiskal, si në vijim:

Neni 27

Skadimi i ndarjeve buxhetore në fund të viti fiskal

Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 Dhjetorit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të cilat ndërlidhen me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të komunave, apo të ndonjë organizate tjetër buxhetore të cilës i janë lejuar me ligj, e të cilat barten në vitin vijues.

5. Nisur mbi premisat e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizata ka bërë ndryshimin e planit të buxhetit për vitin 2026 dhe ka bërë bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2025. Përkundër kësaj, realizimi i suksesshëm i një procesi të tillë karakterizohet me detaje teknike buxhetore për të cilat organizatat buxhetore bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Buxhetit.
6. Ne këtë kuptim, Ministria konstaton se ligjërisht, Komunave ju mundësohet që këto bilance të përdoren për të financuar edhe projekte të reja dhe ekzistuese në vitin aktual, mirëpo realizimi i suksesshëm i tyre kushtëzohet me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.
7. **Rrjedhimisht, akti administrativ i Komunës së Drenasit është në përputhje me legjislacionin në fuqi - me kusht që Komuna të bashkëpunojë ngushtë dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe/apo rekomandimeve të Departamentit të Buxhetit.**

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit, dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

****Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave****

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT	
MINISTERIA E FINANÇAVE / MINISTARSTVO ZA / VANUJE - MINISTRY OF FINANCE	
Nr. i Dregës / Dreg. Jaktim / Dreg. Uakt:	02 MAPL / 885 / 2026
Nr. i fjalës / Broj. stranim / No. pages:	05, 05, 26
PRISHTINË / PRISTINA / PRISHTINA	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Anton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Glllogocit Kryesuesi i KK - Glllogoc Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL.	
Nga:	Erbiln Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor	Date: 04.05.2026 VI-020-320
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit	
	2 Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë, për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale	
Lënda:	Shkresë përcjellëse në MF	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar: Vendimin 02Nr.400/01-15718 për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake nga tejkalimi në vitin 2025 të barten në vitin 2026 dhe bartjen e fondeve, bilancet e pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026, i miratuar në Kuvendin e Komunës së Glllogocit dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe në nenet 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 02Nr.400/01-15718 për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake nga tejkalimi në vitin 2025 të barten në vitin 2026 dhe bartjen e fondeve, bilancet e pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026

I miratuar më datë: 30.04.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.05.2026



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Mitrovicë)
Kuvendi i Komunës



02.Nr. 100/CA-AS/Pr. 30/04/2026

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit të Vetëqeveritjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit në hucanoni me nenin 8, pikën 1.2 dhe paragrafët 6 dhe 7 të ligjit nr.10/L-001 mbi ndryshjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, nenin 2 të ligjit nr.03/L-049 për financat komunale lokale dhe nenin 27 të L.NJPP nr. 03/L-048, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026 miratoi këtë:

Kuvendi i Komunës së Drenasit	
Miratuar në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026	
Kryetari i Komunës	
[Signature]	
[Stamp]	

VENDIM
PËR RRITJEN DHE BARTJEN E TË HYRAVE
VITANAKE NGA TËRKALIMI NË VITIN 2025 TË BARTËN VITIN 2026
DHE
BARTJEN E FONDEVE BILANSET E PASHPENZUARA TË HYRAVE VITANAKE NGA VITI
FISKAL 2025 DHE VITET PARAPRAKË NË VITIN 2026

Neni 1
Rritja dhe bartja e mjeteve financiare nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake në vitin 2025 dhe bartën në vitin 2026 në shumën 803,814.19 €.

Neni 2
Të hyrat vetanake për bartje nga bilancet e pashpenzuara janë gjithsej 247,603.54 €, përfshirësi: Fondi burimor 21 në shumën 136,853.21 € dhe Fondi burimor 22 në shumën 110,750.33 €.

Neni 3
Bartja e tërësishme nga neni 1 dhe neni 2, në vlerën 1,051,417.73 € shpërndahen në këto nën-programe dhe kategori ekonomike të shpenzimeve, vijon:

<u>Në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime, shuma prej 107,041.01€ në nën-programet:</u>	
Infrastruktura Rrugore (18001),.....	20,000.80 €
Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100),.....	52,831.80 €
Arsimi Parashkollor (92210),.....	32,813.98 €
Shërbimet Sociale (75501),.....	1,395.23 €
<u>Në kategorinë e shpenzimeve komunale, shuma prej 81,204.86 € në nën-programin:</u>	
Infrastruktura Rrugore (18001),.....	81,204.86 €
<u>Në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere, shuma prej 11,799.05 € në nën-programet:</u>	
Zyra e Kryetarit (16001),.....	2,350.00 €
Administrata (73010),.....	1,449.05 €
Infrastruktura Rrugore (18001),.....	7,000.00 €
Administrata (92005),.....	1,000.00 €
<u>Në kategorinë e shpenzimeve investive kapitale, shuma prej 851,372.81 € në nën-programet:</u>	
Infrastruktura Publike (18161), në projektet:	

"Zgjedhimi dhe ndërtimi i shtëpitë" Fshati e Xheva (Jachkoveci) Drenas, Kodi (19297), në vlerë prej.....	301,605.00 €
"Rehabilitimi i rrugës dhe ndërtimi i trotuarit Avllat-Negrove dhe Vuqak", Kodi (55568) në vlerë prej.....	100,000.00 €
"Asfaltimi në fshatin Zabel i ulët dhe Lipern, Kercatë e ulët dhe operim" Kodi (88658), në vlerë prej.....	7,052.71 €
"Ndërtimi, zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugëve të asfaltuar, Kodi (53660) në vlerë prej.....	15,409.91 €
"Asfaltimi i rrugëve në fshatin Nekae, Kishinok (53672) në vlerë prej.....	15,471.72 €
"Asfaltimi i rrugës Bates, Krajkovë, Damaok, Shubullayvë (53680) në vlerë prej.....	9,990.30 €
Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor (73100):	
"Pajisje speciale mjekësore ndih 1000" (19181), në vlerë prej.....	11,402.97 €
Arvanit Ilirë, i mesëm Fshat (93100):	
"Projekti Digitalizimi i Institucioneve Arsimore në Drenas", Kodi (51325), në vlerë prej.....	20,417.20 €

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshëmrisë nga MATP -ju, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueh faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- o Zyrës së Kryetarit;
- o Drejtoriatë Përkateso;
- o Zyrës së Kuvendit;
- o Arkivit



Kryetari i Kuvendit Komunal

[Signature]
Enxhin Bajupi

Arsyetimi

Marrja e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat votuato dhe tregja e buxhetit si rezultat i tejkalimit të planifikimit të të hyrave të vitit paraprak hartua në kategoritë e shpenzimeve; anulim dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale. Përkatesisht, buxhetohen obligimet ashtu siç kanë qenë të planifikuara në vitin paraprak, veçanërisht duke marrë parasysh ndikimin negativ të shkaktuar në këto kategori të shpenzimeve nga ekzekutimet e vendimeve përmbledhore/gjyqësore gjatë vitit 2025, si dhe edhe gjatë këtij viti.

Projekti "Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Fehmi e Xheva Madrovci", Drenas", kodi (49297), vlefshmeohet në shumën 301,605.00 E, përkatesisht në shumën e njëjtë që është shkaktuar buxheti nga MPPF në vitin 2024, duke u transferuar në kodin nr. 00040 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Projekti "Rehabilitimi i rrugës dhe ndërtimi i trotuarit Arllat-Nëgrove dhe Vuqale" ka qenë i planifikuar dhe buxhetuar në vitin 2025, por për shkak të ankesave të OJL në OSHP, kontrata për projektin në fjalë, me vendim të OSHP-së, është shtuar në vitin 2026. Andaj, kërkohet që të buxhetohet ky projekt në shumën 400,000.00 E. Po ashtu, edhe projektet në vijim financohen në shumën e planifikuar të vitit paraprak: "Asfaltimi në fshatit Zabel i Ulër dhe i Uperit, Korraticë e Ulët dhe e Tëpërre", kodi (48658), "Ndërtimi, zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara", kodi (51660), "Asfaltimi i rrugëve në fshatit Nekao, Kishmarck", kodi (51672), "Asfaltimi i rrugës Buletë, Krafkovo, Dumanek, Shtrubullovo", kodi (51340), "Pufisja speciale mjekësore mbi 1000 E", kodi (49181), "Projekti Dëgjitalizimi i Institucioneve Arsimore në Drenas", kodi (51325).